



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 134/2 Prot.

Tiranë, më 15.04.2022

**V E N D I M**

Nr.54, datë 15.04.2022

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë të procesit të transferimit të përkohshëm, të nëpunëses \*\*\*\*\*, nga pozicioni “Drejtor, në Drejtorinë e Financës”, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventaresh”, në Bashkinë Krujë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa pretendime prej nëpunëses \*\*\*\*\*, për paligjshmërinë e procesit administrativ të transferimit, nga pozicioni i punës “Drejtor”, në Drejtorinë e Financës, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventaresh”, në Bashkinë Krujë, kryer me Urdhrin nr. 539, datë 26.08.2019, “Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”, të Kryetarit të Bashkisë Krujë.

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet një kërkesë të regjistruar me nr. 134 prot., datë 02.02.2022, paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\*, është marrë informacion për disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë procesit administrativ të transferimit, nga pozicioni i punës “Drejtor”, në Drejtorinë e Financës, në pozicionin “Specialist finance, arke, inventaresh”, në Bashkinë Krujë, kryer

me Urdhrin nr.539, datë 26.08.2019, të Kryetarit të Bashkisë Krujë “Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”.

Nëpunësja në fjalë, pretendon se është nëpunëse civile e deklaruar, në pozicionin “Drejtor, në Drejtorinë e Financës” në Bashkinë Krujë dhe pa u respektuar rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, ka kaluar në pozicionin “Specialist finance, arke, inventaresh”, në Bashkinë Krujë. Sipas saj, shkeljet konsistojnë:

Së pari, në faktin se, kjo lëvizje është kryer si transferim i përkohshëm, në një pozicion pune me kategori më të ulët;

Së dyti, urdhëri i transferimit të përkohshëm është i paligjshëm pasi nuk ka të përcaktuar qartësisht afatin dhe kohëzgjatjen e transferimit.

Për problemet e mësipërme, rezulton se nëpunësja \*\*\*\*\*, fillimisht i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike (me një kërkesë të regjistruar me nr. 7035 prot., datë 20.12.2021), duke kërkuar ndërhyrjen e tij për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, mbi procedurat e ndjekura nga njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Krujë, për transferimin e përkohshëm të saj.

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 7035/1 prot., datë 28.12.2021, “Kthim përgjigje suajës nr. 7035 prot., datë 20.12.2021”, ka sqaruar nëpunësen në fjalë se, referuar pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, DAP, është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, ndërsa për institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësi përgjegjëse, është njësia e burimeve njerëzore e institucionit, prandaj bazuar në nenet 11 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përfundimisht e ka orientuar nëpunësen ti drejtohet KMSHC-së, për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë për problemin në fjalë.

Mbi këtë bazë, nëpunësja i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me një kërkesë që është regjistruar me nr. 134 prot., datë 02.02.2022.

Për efekt të kryerjes së hetimit administrativ dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, u shqyrtua materiali shkresor që shoqëronte kërkesën e nëpunëses dhe dokumentacioni i përcjellë nga Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr.7035/1 prot., datë 28.12.2021, “Kthim përgjigje suajës nr. 7035 prot., datë 20.12.2021” drejtuar ankueses si dhe të dhëna të tjera që u administruan nga Bashkia Krujë.

Në përfundim të verifikimit të këtij rasti, rezulton e vërtetuar se nëpunësja \*\*\*\*\*, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ka qenë nëpunës civil ekzistues në Bashkinë Fushë Krujë, (sipas aktit të deklarimit të statusit të

*punësimi nr. 3 prot., datë 10.04.2014, në pozicionin e punës “Drejtor, në Drejtorinë e Financës” në Bashkinë Fushë Krujë).*

Bazuar në ligjin nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar*”, ish Bashkia Fush-Krujë, kaloi në përbërje të strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Krujë dhe si rrjedhojë ankuesja me urdhrin nr. 96, datë 29.09.2015, *“Për emërim në detyrë”*, kaloi në pozicionin *“Drejtor, në Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financës”*, në Bashkinë Krujë.

Kjo nëpunëse ka vijuar punësimin e saj në këtë detyrë deri në momentin që me Urdhrin nr.539, datë 26.08.2019, *“Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”*, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, është vendosur transferimi i përkohshëm i saj, në një pozicion pune me kategori më të ulët dhe konkretisht në pozicionin *“Specialist finance, arke, inventaresh”*, në Bashkinë Krujë.

Duke mos qenë dakord me këtë qëndrim të institucionit, punonjësja në fjalë, me një shkresë të protokolluar me nr. 5645 prot., datë 27.08.2019 *“Kundërshtim urdhri”*, e ka kundërshtuar duke kërkuar argumentimin e lëvizjes në këtë pozicion pune me kategori më të ulët, si dhe rishikimin e bazës ligjore të këtij urdhri.

Njësia e burimeve njerëzore pranë Bashkisë Krujë, pasi ka marrë në shqyrtim rastin, ka vendosur me Urdhrin nr. 576, datë 30.08.2019, *“Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”*, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, lirimin nga detyra *“Drejtor, në Drejtorinë e Financës”* dhe kalimin e saj në pozicionin *“Specialist detyrimesh fiskale”*, në Bashkinë Krujë.

Më tej, meqënëse nuk mori përgjigje pozitive për ankesën e bërë, me kërkesën e përsëritur me nr. 5644 prot., datë 15.09.2020, *“Kërkesë”*, nëpunësja ka kërkuar prej njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Krujë, rishikimin e aktit të transferimit të saj dhe pagesën e diferencës së pagës, nga data e hyrjes në fuqi të Urdhrit nr. 576, datë 30.08.2019, *“Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”*, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, deri në momentin e kthimit të saj në pozicionin e mëparshëm të punës *“Drejtor, në Drejtorinë e Financës”*. Për asnjë nga këto ankesa, nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë reagim nga ana e njësisë përgjegjëse dhe drejtuesi i Bashkisë Krujë.

Në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të transferimit të mësipërm, duke e parë në brendësi përmbajtjen e aktit nr. 576, datë 30.08.2019, *“Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”*, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, konstatohet që jemi para një akti i cili karakterizohet nga një sërë parregullsish e paligjshmërish të cilat parashtrihen sa më poshtë:

- Akti nr. 576, datë 30.08.2019, i Kryetarit të Bashkisë Krujë, megjithëse emërtohet “*Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë*” përmban si bazë ligjore Vendimin nr. 243 dt. 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i cili nuk ka asnjë lidhje ligjore me veprimin administrativ të kryer. Nisur nga emërtimi i aktit, baza ligjore duhej të ishte përcaktuar neni 48, i ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, dhe vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.
- Duke supozuar se jemi para një transferimi të përkohshëm, konstatohet që akti ka disa elementë të tjerë paligjshmërie, siç është mosrespektimi i kushtit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, ku parashikohet se, gjatë transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, ose në një kategori më të lartë.
- Gjithashtu në këtë akt nuk është shënuar kohëzgjatja dhe arsyeja e transferimit të nëpunëses, përcaktuar në dispozitën e mësipërme. Në aktin e transferimit të përkohshëm duhet të përcaktohet në mënyrë të shprehur koha e transferimit të përkohshëm dhe data e kthimit në pozicionin e mëparshëm, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme, duke i siguruar nëpunëses mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së saj, pas përfundimit të afatit të transferimit.
- Edhe përcaktimi i pagës në Urdhërin nr. 576, datë 30.08.2019, “*Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë Krujë, është bërë në kundërshtim me mënyrën e përcaktuar në pikën 5, të nenit 48, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, që nëpunësi civil merr pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm me pozicionin dhe atij në të cilin është transferuar përkohësisht.
- Nëse në këtë transferim, i cili në përmbajtje është zbritje në detyrë, do të ishim para një mase ndëshkimore, por të paraqitur, padrejtësisht, si transferim i përkohshëm apo i përhershëm, do të ishte e detyrueshme të zbatohet procedura e përcaktuar në dispozitat e neneve 57 deri 60, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, mosrespektimi i të cilës do të passillte pavlefshmëri absolute të veprimit administrativ.
- Tejkalimi i dukshëm, i afatit maksimal të transferimit të përkohshëm të përcaktuar në pikën 1, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, tregon pikërisht, faktin se në këtë rast qëllimi i këtyre veprimeve administrative ka qënë spostimi i nëpunëses \*\*\*\*\*, nga pozicioni “*Drejtor i Drejtorisë së Financës*” në

Bashkinë Krujë dhe jo transferimi i saj i përkohshëm për nevoja të institucionit, për përmirësimin e rezultateve në punë të vetë nëpunësit apo për arsye shëndetsore, etj.

Përveç sa më sipër, akti është i kundraligjshëm edhe në lidhje me mosrespektimin e procedurës së përcaktuar në vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, ku përcaktohet procedura që duhet të ndiqet si dhe organi kompetent për kryerjen e këtij transferimi.

Konkretisht, në Kreun I, pika 4 dhe 5, të këtij akti nënligjor, përcaktohet se, nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit, me kërkesë të institucionit, drejtorisë së interesuar apo njësisë së burimeve njerëzore. Ky transferim duhet të miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila duhet të njoftojë me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet.

Nga sa u parashtrua më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar konstatohet se, mosrespektimi i procedurës së mësipërme ligjore, në kuptim të nenit 109, germa *“a”*, *“b”*, dhe *“d”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përcakton paligjshmërinë e Urdhrit nr. 576, datë 30.08.2019, *“Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”*, të Kryetarit të Bashkisë Krujë.

#### **Për këto arsye:**

Në zbatim të nenit 15 pika 1, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, të nenit 109, gërmat *a*, *b* dhe *d*, të ligjit nr.44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, dhe neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë:

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga njësi përgjegjëse e Bashkisë Krujë, që të drejtojë procesin administrativ nëpërmjet të cilit, organi publik Kryetari i Bashkisë Krujë, të anulojë urdhrin nr. 576, datë 30.08.2019, *“Për lëvizje dhe emërim të përkohshëm në detyrë”*, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin, nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të urdhërojë kthimin e nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin e saj të mëparshëm të punës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, lihet një afat 20 ditë, nga data e komunikimit të vendimit.

3. Ky vendim ti komunikohet, Kryetarit të Bashkisë Krujë, njësisë përgjegjëse të Bashkisë Krujë dhe nëpunëses \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**